



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Kryetari i Komunës – Presedhniku Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Urbanizim, Planifikim dhe Mir. i Mjedisit
Odeljenje za Urbanizam, Planiranje i Zast. Sredine

XII- Nr. i prot. 127 Më 09.06.2021
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Raporti i Përformancës Janar – Dhjetor 2020



PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	1
Raport për Performancën Komunale Janar-dhjetor 2020	2
Fusha e parë - Shërbimet publike administrative	3
Fusha e dytë -Transparenca	3
Fusha e tretë- Përgjegjshmëria Komunale.....	3
Fusha e katërt- Barazia në Punësim , Shërbimet Sociale dhe Familjare	4
Fusha e pestë - Kulturë, Rini dhe Sport.....	4
Fusha e gjashtë- Menaxhimi i Fatkeqësive.....	5
Fusha e shtatë- Planifikimi Hapësinor Komunal	5
Fusha e tetë- Hapësirat Publike	5
Fusha e nëntë- Infrastruktura Rrugore.....	5
Fusha e dhjetë- Transporti Publik.....	6
Fusha e njëmbëdhjetë – Parkingjet Publike.....	6
Fusha e dymbëdhjetë- Uji i Pijshëm.....	6
Fusha e trembëdhjetë -Kanalizimi	6
Fusha e katërbëdhjetë –Menaxhimi i Mbeturinave	6
Fusha e pesëmbëdhjetë–Mbrojtja e Mjedisit	7
Fusha e gjashtëmbëdhjetë -Përfaqësimi Gjinor	7
Fusha e shtatëmbëdhjetë-Arsimi Parauniversitare.....	7
Fusha e tetëmbëdhjetë –Kujdesi Primar Shëndetësor.....	8
Fusha e nëntëmbëdhjetë–Zhvillimi Ekonomik Lokal	8

1. HYRJJE

Në bazë të udhëzimit të punës së sistemit të menaxhimit të performancës komuna raporton për 19 fusha gjithsej.

Udhëzimet e punës kanë për qëllim prezantimin e tregueseve të cilët përbëjnë SMP-në përkatësisht informimin e zyrtarëve përgjegjës se si janë ndërtuar treguesit edhe të cilat të dhëna janë të nevojshme për të plotësuar raportimin për secilin tregues të veçantë.

Për vitin e raportuar të vitit pasues bëhet:

- Mbledhja ,
- Verifikimi dhe
- Raportimi përfundimtar i të dhënave nga komunat në sistem elektronik.

MAPL dërgon njoftimin me pakon e dokumenteve përcjellëse të koordinatori komunal, ku ky raport përbehet prej :

- Njoftimi për raportimin ,
- Dokumentimin etj.

Sistemi i SMP-së do të jetë i bazuar në aplikacionin softuerik të zhvilluar enkas për sistemin e mbledhjes edhe të raportimit i cili shfrytëzon formularë elektronik.

- Kontrollon nëse të dhënat janë transformuar automatikisht nga secili formular 1
- Në formularin 2 në formën elektronike .

Komuna raporton për 19 fusha tregues, autorizimin e të dhënave e bën kryetari i Komunës .

Treguesi 2.3.3% e diskutimit të raportit të performancës komunale nga kuvendi komunal nga viti paraprak ku kërkohet të bëhet prezantimi para datës 30 qershor .

Në vazhdim do të raportojmë për 19 fusha në bazë të udhëzimit të punës së sistemit të menaxhimit të performancës .

Fusha e parë - Shërbimet publike administrative

Te Administrata në përgjithësi kërkohet numri i lëndëve të parashtruar gjatë tërë vitit ,numri i lëndëve të shqyrtuara gjatë një viti nga ana e Komunës ,problemi është tek numri i lëndëve të cilat janë të shqyrtuara brenda afateve të parapara nëpër të gjitha drejtoritë ,problemi është te Intraneti,në bazë të raportit që kërkohet nga përformanca nga numri i gjithmbarshëm i kërkesave duhet të kategorizohen lëndët në bazë të afateve 7 ditore,10 ditore,15 ditore ,30 ditore dhe 45 ditore varësisht nga rëndësia e lëndës ,besoj edhe shpresoj kjo çështje të rregullohet ,edhe pse këtë vit kemi raportuar për dy fusha për 1.1 % të lëndëve të shqyrtuara gjatë vitit ,dhe për 1.2 % të lëndëve të shqyrtuara brenda afateve ligjore kurse për 1.3 nuk kemi raportuar sepse treguesi ka qenë I ngrirë nga MAPL.

Fusha e dytë -Transparenca

Te kjo fushë është plotësuar dhe kemi vlerat 100% në të gjithë fushën e transparencës p.sh. te fusha e sigurimit të pjesëmarrësve të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, sigurimi i qasjes së dokumenteve publike ,sigurimi i llogaridhënies dhe respektimi i afateve ligjore në proceset e kuvendit komunal.

Fusha e tretë- Përgjegjshmëria Komunale

Te kjo fushë janë publikimi i njoftimeve për takimet publike ,aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale te konsultuara me publikun ,dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunale ,publikimi i raporteve për procese publiku ,këshillat lokal ,diskutime për raport buxhetore tremujore nga Kuvendi Komunal ,diskutimet e Raportit te auditorit të jashtëm dhe planit te veprimit te ne adresim te rekomandimeve te Kuvendit Komunal, diskutimi I auditorit te brendshëm dhe planeve te veprimit te kuvendit komunal, niveli I zbatimit te planit te prokurimit rreth 23 tregues janë te kjo fusha përgjegjshmëria e cila për këtë vitë ka arritje maksimale.

Fusha e katërt- Barazia në Punësim , Shërbimet Sociale dhe Familjare

Duhet të raportohet numri i përgjithshëm i personave me aftësi të kufizuara në Institucione, me këtë kuptojmë për krijimin e një mjedisi jetësor që i trajton në mënyrë të barabartë të gjithë qytetarët.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në institucione komunale dhe prej këtij numri kërkohet numri i femrave të punësuar në institucione komunale gjithashtu prej saj kërkohet numri i komuniteteve sa janë të punësuar , sa familje kanë kërkesa sa i takon strehimit dhe sa kërkesa janë të plotësuar.

Numri i pjesëmarrësve në takime publike sa kanë qenë dhe numri i grave sa ka qenë në takime publike.

Numri i përgjithshëm i grave të emëruara në postet politike dhe numri i zyrtarëve të emëruar në postet politike. Kjo fushë ka arritje maksimale vetëm te të punësuar me nevoja te veçanta ka përqindjen më të ultë rreth 37.62%.

Duhet çdo punëtor i ri që punësohet të vendoset në SIMBNJ –Sistemin informues të burimeve njerëzore.

Unë mendoj të gjitha këtyre duhet t'iu japim rëndësi sepse i kemi vlerat më të ulëta të raportuara duke filluar nga % e të punësuarve me aftësi të kufizuara ,% e përkatësive gjinore ,% e të punësuarve nga komuniteti jo shumicë ,% e grave pjesëmarrëse në takimet publike ,% e zyrtarëve publik te jenë femra ,% e familjeve në nevojë te cilave iu është siguruar banimi, % e popullatës të skemës sociale ,% e ankesave të miratuara për skemën e ndihmës sociale ,% e zbatimit të skemës në shpërndarjen e vlerësimit të punës së shërbyesve civil ,% e vendeve të hapura të punës sipas SIMBNJ, % e prezantimit për diskutim në Kuvendin Komunal.

Fusha e pestë - Kulturë, Rini dhe Sport

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport duhet të ketë plan vjetor me numër të projekteve të planit lokal për veprimtaritë kulturore, rinore dhe sportive ,po ashtu edhe sa janë realizuar, numri projekteve të realizuara për veprimtaritë kulturore ,rinore, sportive ,duhet të kenë të dhëna sa i takon numrit të pjesëmarrësve nëpër aktivitete të ndryshme kulturore ,sportive dhe rinore, te këto fusha ka dalë % rreth 80 % ku mendoj vetëm më me pak kujdes të realizohet plani vjetor edhe për veprimtaritë kulturore ,sportive e rinore të kemi të dhëna si numrin e pjesëmarrësve po ashtu edhe realizimin e planit vjetor për këto veprimtari rinore, sportive dhe kulturorë që në vitin 2020 të realizohet 100% për këtë vit për shkak të situatës pandemie treguesit janë te ngrirë vetëm treguesi i hapësirës është matur për këtë vit.

Fusha e gjashtë- Menaxhimi i Fatkeqësive

Duhet të ketë plan vjetor të punës dhe kërkesa është sa aktivitete apo projekte i ka planifikuar dhe sa i ka realizuar gjatë vitit kalendarik ,sa raste emergjente kanë qenë gjatë vitit dhe sa intervenime janë bërë gjatë vitit, kjo fushë mendoj që është mirë ka vlera 100% .

Fusha e shtatë- Planifikimi Hapësinor Komunal

Te kjo fushë ka mangësi të mëdha sa i takon planeve të hollësishme si planet urbane ,planet rregulluese ,përveç që ka një plan zhvillimor, por po presim që së shpejti të jetë gati Harta Zonale përveç kësaj kërkohet edhe numri i lejeve ndërtimore në raport me numrin e inspektimeve nga drejtoria e Inspektoratit ku thuhet përveç që inspektori del në terren të i kërkohet leje ndërtimore palës ajo duhet ti inspekton edhe ato objekte që kanë marrë leje , kjo fushë nuk ka vlera të mira për arsye se kemi mungesë të planeve gjithashtu edhe numri i inspektimeve te lejet nuk është në nivel me numrin e lejeve ndërtimore që janë dhënë nga Drejtoria për Urbanizëm.

Fusha e tetë- Hapësirat Publike

Në Komunë ka përmasime dukshme me rregullimin e hapësirave publike mirëpo ende ka nevojë po ashtu edhe sipërfaqet duhet të mirëmbahen edhe kërkohet te jenë te pajisura me ndreqim publik duhet te kemi kujdes te veçante për hapësirat publike.

Fusha e nëntë- Infrastruktura Rrugore

Gjatësia e rrugëve të përgjithshme lokale të shtruar ,ky tregues mat performancën komunale me asfaltim apo kupëza në kilometra gjatësi nga gjatësia totale e rrugëve lokale në kilometra ,për këtë tregues duhet të përcaktohen qartë rrugët rajonale edhe kombëtare të cilat kalojnë nëpër territorin e Komunës sonë .

Sa i takon kësaj fushe duhet ti japim rëndësi më shumë të që të mirëmbahen rrugët po ashtu edhe ndriçimi është si mangësi dhe duhet ti kemi si prioritet edhe rrugët e reja që ndërtohen dhe varësisht nga terreni të jenë të ndërtuara me trotuare aty ku është mundësia . Për vitin 2020 përqindja e rrugëve lokale të shtruara është 81.89 të mirëmbajtura 86.75 kurse rrugët lokale me trotuare janë 43.09% kurse rrugët me ndriçim publik me 49.74 % kurse të she njëzuara 100% është mirë ti japim mundësi aty ku ka përqindje më të vogël të rregullohet nëse kemi mundësi buxhetore p.sh. te shteg të biçikletave 45.53% te kjo fushë gjendja është e mirë por ka nevojë për rregullimin.

Fusha e dhjetë- Transporti Publik

Transporti publik te kjo fushë nuk është keq besoj se ende ka nevojë edhe pse te kjo fushë kemi 100% raportimin por duhet te kemi kujdes te përcjellim gjate gjithë kohës rreth transportit publik.

Fusha e njëmbëdhjetë – Parkingjet Publike

Ka mangësi të parkingjeve në Komunën tonë pothuajse në këtë fushë nuk jemi mirë sa i takon parkingjeve por jo edhe aq keq ka nevojë ende te kemi parkingje publike sidomos për personat me aftësi të kufizuara .

Fusha e dymbëdhjetë- Uji i Pijshëm

Gjitha të dhënat janë marrë nga Hidrosistemi i Radoniqit ,kishte qenë mirë nëse është e mundur që komuna të ketë një raport tre mujor ,gjashtë mujor edhe vjetor nga kompania sa i takon furnizimit me ujë të pijes gjithashtu edhe kyçjes së furnizimit ,te ne janë të përfshirë jemi ne gjendje te mire te kjo fushë me përqindje maksimale 100%.

Fusha e trembëdhjetë -Kanalizimi

Thuajse të gjitha vendbanimet janë të kyçura në sistemin e kanalizimit ,në këtë fushë është mangësi trajtimi i ujërave të zeza ,ndërtimi , zgjerimi dhe mirëmbajtja e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza ,mangësi.

Fusha e katërbëdhjetë –Menaxhimi i Mbeturinave

Komuna e ka planin vjetor sa i takon menaxhimit të mbeturinave, po ashtu edhe sa janë të realizuara nga plani gjithashtu duhet të kemi raport vjetor, sepse plani është pesëvjeçar .

Në Komunën tonë janë 36 vendbanime të kyçura në sistemin e mbeturinave andaj duhet të kërkojmë nga kompanitë përkatëse që mbledhin mbeturinat dhe kompania na sjellin raport mujor ,tremujor dhe vjetor për mbledhjen dhe menaxhimin dhe deponimin e tyre .

Fusha e pesëmbëdhjetë-Mbrojtja e Mjedisit

Te kjo fushë e kemi plani lokal dhe veprimet ne mjedis dhe lejet mjedisore te leshura ka nevojë gjithmonë për mbrojtjen e mjedisit kur ne në përgjithësi duhet te krijojmë mekanizëm mbrojtëse apo taks forcë ne mbrojtjen te mjedisit ne vazhdimësi .

Fusha e gjashtëmbëdhjetë -Përfaqësimi Gjnor

Te kjo fushë ka tregues te shumtë dhe është fushë e re qe po raportojmë duke filluar nga gratë e punësuar ne institucione ne administratën komunale ,në pozita udhëheqëse ne institucione arsimore ,shëndetësore dhe kulturore ,sportive tek barazia gjnore tek anëtarët e komiteteve komunale dhe përbërja e këshillave lokale tek buxhetimi dhe shpenzimi I përgjegjshëm gjnor ,plani komunal për barazi gjnore dhe barazia gjnore tek emërtimet e rrugëve dhe regjistrimi I pronësisë ne emër te dy gjnive te kjo është fushë ka nevojë për përmasime.

Fusha e shtatëmbëdhjetë-Arsimi Parauniversitare

Fusha e Arsimit është fushe e re nuk ka gene vitet me herët ka mjaft tregues për Arsim me rendësi te veçantë duke filluar plotësim i buxhetit për Arsim prej te hyrave vetanake ,plotësimi i vendeve te lira të punës në arsim me konkurs plotësues ,respektimi i procedurave ligjore për zgjedhjen e stafit drejtues te shkollave ,fëmijët që vijojnë kopshtin ne urbane dhe rurale ,shkalla bruto e regjistrimit ne klasën e 1 dhe shkalla e qasjes –tranzincioni klasa 9-kl 10.Rezultatet e testit te arriteshmerisë për klasën 9-ta, kalueshmëria në maturën kombëtare kl-12-të braktisja e nxënësve nga shkollat dhe shkalla e realizimit te orëve te planifikuara këta janë nder disa tregues ka mjaft dhe rezultati nuk shumë i kënaqur duhet të ketë përmasime viteve në vazhdim kjo është gjendje reale qe duhet te përmirësohet por janë shume faktorë qe varen edhe nga komuna por edhe Ministria e Arsimit.

Fusha e tetëmbëdhjetë –Kujdesi Primar Shëndetësor

Fusha e Shëndetësisë ka këta tregues m2 të hapësirave për banorë ,objektet e pajisura me laboratorë ,numri I mjekeve familjar edhe infermier për banorë ,përqindja e buxhetit për kujdes primar shëndetësor nga komuna për të hyra vetanake ,numri I vizitave të pacienteve dhe fëmijët e përfshirë në imunizimi këtu ka nevojë ende për përmirësime këtu janë fusha që duhet të japim rendësi të punohet rreth shërbimeve me shume që në të ardhmen të kemi rritje të performancës.

Fusha e nëntëmbëdhjetë–Zhvillimi Ekonomik Lokal

Fusha e fundit është mjaft komplekse dhe përfshin në vetë ekonomin dhe tatimin në pronë . Këtu kërkohet plani lokal ekonomik publikimi dhe përgatitja e pronave të planifikuara për shfrytëzim niveli i Azhurnimit të regjistrimit të tatimit në prone dhe niveli i mbledhjes së faturave ku në si komuna në këtë pjesë jemi mire sa i përket kësaj fushe.

2.PËRFUNDIM

Matja e performancës është një instrument i rëndësishëm i të gjitha programeve të menaxhimit të cilësisë. Si institucion, kemi përgjegjësi të dimë se si, ku, dhe kur duhet t'i marrim masat për ndryshimet e nevojshme në zhvillim të institucionit.

Matja e performancës ka të bëjë me nxjerrjen e përfundimeve apo të mendimeve për të kuptuar se si një sistem i përgjithshëm i menaxhimit të punës ndihmon në identifikimin dhe parandalimin e punës së pasuksesshme, duke ndihmuar komunën në konfirmimin e arritjeve të synuara në ofrimin cilësor të shërbimeve sipas kërkesave të qytetarëve të saj. Përveç kësaj, ka të bëjë me rritjen e optimizmit për punë më efikase dhe më efektive në procesin e ofrimit të shërbimeve cilësore. Këto veprime ndodhin në një cikël të vazhdueshëm, që krijojnë mundësitë për zgjerim dhe përmirësim të procesit të punës në ofrim të shërbimeve sa më cilësore, duke u bazuar në metodologjitë standarde. Qëllimi kryesor është krijimi i bazës relevante profesionale për vendimmarrje praktike dhe strategjike, që ndikojnë në cilësinë e punës së Komunës për të prodhuar shërbime cilësore.

Komuna e Rahovecit është renditur e dyta me radhë duke pranuar kështu edhe çmimin për performancën më të mirë komunale për vitin 2019.

Mbetemi të përkushtuar për tu bërë shembull i mirë i qeverisjes lokale në nivel vendi.

Me respekt!



Rahovec, Qershor 2020